



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

INFORMATË PËR DËRGIMIN E MENDIMIT PËR PROPOZIM LIGJIN PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE TË DREJTUAR PRANË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), në përputhje me autorizimet të cilat rrjedhin nga Protokollin Fakultativ i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese, Ligji për Avokatin e Popullit dhe Rregullorja e Punës së Avokatit të Popullit, më datë 04.09.2012 paraqiti **MENDIM** pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë në lidhje me **Propozim Ligjin për të drejtat e fëmijëve**.

Avokati i Popullit, si Mekanizëm Parandalues Nacional, konsideron se kjo iniciativë (mendim) do të jep kontribut në drejtim të kualitetit të këtij Ligji në aspekt të reduktimit të rreziqeve nga tortura e mundshme ose nga trajtime tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese me fëmijët e privuar nga liria.

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) konsideron se me këtë Propozim Ligj për të drejtat e fëmijëve duhet të përforcohen mekanizmat për mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e fëmijëve të privuar nga liria, në përputhje me Rregullat Standarde Minimale të KB-së për administrimin e drejtësisë për të mitur (të ashtuquajtura Rregulla të Pekinit).

Në propozim tekstin aktual nuk parashikohet nëpunës policor i cili do ta zhvillojë procedurën me fëmijën gjatë thirrjes, shoqërimit ose ndalimit të tij në stacion policor, por i njëjti vetëm u referohet dispozitave të Ligjit për policinë.

MPN-ja, përmes Mendimit të paraqitur pranë Ministrisë së Drejtësisë, sugjeroi se me zgjidhjen e këtillë nuk mundësohet mbrojtje shtesë e fëmijës në procedurë para Ministrisë për Punë të Brendshme, por këtë çështje e riorienton në Ligjin për polici në të cilin, edhe pse parashikohet që me personat e mitur të veprojnë nëpunës të trajnuar të posaçëm megjithatë, në situata të jashtëzakonshme, lejohet që me ta të veprojnë edhe nëpunës tjerë policorë.

Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë vizitave të rregullta dhe të përsëritura kohë pas kohe nëpër stacionet policore me kompetencë të përgjithshme, të cilët kanë autorizim për të ndaluar persona, konstatoi se një numër i caktuar i tyre nuk kanë caktuar inspektor të posaçëm për delikuençë tek të miturit, i cili do të ishte i trajnuar në mënyrë adekuate për veprim të tillë. Prandaj, MPN-ja kërkoi zbatim të plotë të këtij standardi juridik-ndërkombëtar drejtpërdrejtë në Ligjin për drejtësinë e fëmijëve, duke e pasur parasysh qëllimin e këtij Ligji – harmonizimin me standarde ndërkombëtare për avancimin e legjislacionit për fëmijë, përmirësimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

MPN-ja dha mendimin e vet edhe në pjesën e përkufizimit të asaj se çka do të thotë “interesi më i mirë i fëmijës”, me ç’rast në bazë të informatave nga vizitat e realizuara, është

e nevojshme të konstatohet se: **“Interesi më i mirë i fëmijës kërkon që fëmija të mos jetë çdoherë dhe tërësisht vet dhe i ndarë, gjë që do të ndikonte negativisht në zhvillimin e tij normal psikofizik.”**

Vendosja e fëmijëve në paraburgim, ndaras nga personat e moshës madhore, është standard juridik-ndërkombëtar dhe obligim i cili rezulton fillimisht nga neni 10 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike. Megjithatë, në situata të caktuara, vetëm kur një gjë e tillë është konform interesit më të mirë të fëmijës, MPN-ja konsideron se duhet të lejohen përjashtime të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht me mundësimin e kontakteve ditore dhe të kohëpaskohshme me persona të moshës së re madhore, të zgjedhur me kujdes. Këto përjashtime do të aplikoheshin vetëm sa u përket kontakteve dhe përfshirjeve në aktivitete të përbashkëta, e jo edhe sa i përket vendosjes së fëmijës.

MPN-ja konsideron se në plan afatgjatë, privimi i fëmijës nga liria, përfshirë këtu edhe ekzekutimin e masës parandalim, duhet të zbatohet vetëm në institucione të veçanta për fëmijë të privuar nga liria, të cilët përfshijnë personel të trajnuar të posaçëm dhe politika e praktika të cilat në qendër të vëmendjes së tyre do ta kishin trajtimin me fëmijët.